

## KONTRATË SHITJE KUOTASH "SIGURIA PRESION" sh.p.k

Në Tiranë, sot më datën 13.02.2020, me palët e mëposhtme:

**PALA SHITËSE Viktor Kostandini**, atësia Jovan, datelindja 23.04.1942, lindur ne Fier, banues në Tiranë, 9305, Fier, rr "Thoma Kopace", nr. 8/1, 4 6, i martuar, i regjistruar me nr personal E20423005M ortak i vetëm ishoqërisë "SIGURIA PRESION" sh.p.k, rregjistruar person juridik me NIPT K82008005K, JEP PELQIMIN bashkëshortja Shpresa Kostandini, atësia Trifon, datelindja 20.05.1948, lindur ne Fier banues në Tiranë, 9305, Fier, rr "Thoma Kopace",nr. 8/1, 4 6, i martuar, i regjistruar me nr personal E85520011O

**PALA BLERËSE Ergest Mileti**, atësia Polikseni, datëlindja 02.07.1990, lindur ne Fier, banues në Tiranë, 1019, nj 5, rr Osman Mnyderizi, p 6, h 3, ap 17, i martuar, i regjistruar me nr personal J00702026K Madhorë, me zotësi të plotë juride dhe për të vepruar, me vullnet të lirë, të plotë dhe të pavesuar hartojmë këtë kontratë shitje pjesësh kapitali themeltar, si më poshtë vijon:

### BAZA LIGJORE

Baza ligjore e lidhjes së kësaj kontrates është: Neni 705 e vijues të Kodit Civil në fuqi; Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

### OBJEKTI I KONTRATËS

Shitja e 100% të kuotave të kapitalit themeltar që pala shitëse Viktor Kostandini zotëron tek shoqëria "SIGURIA PRESION" sh.p.k

### NENI 1

#### PËRMBAJTJA E KONTRATËS

- 1.1 Pala shitëse është ortak në shoqërinë "SIGURIA PRESION" sh.p.k, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar, themeluar më datë 07.08.2008, me numër Nipt-i (NUIS) K82008005K me seli në Tiranë, Bexull Rruga Industriale, Km 10, Ndertesë me zone kadastrale 1167, nr. pasurie 701-2, pran Global Gaz Sh.a. Pala shitëse, është zotërues i 100 pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë, me pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar e barabartë me 100.000,00 lekë (njëqindmijë).
- 1.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 lekë (njëqindmijë) dhe është i ndarë në 100 pjesë (njëqind).
- 1.3 Pala shitëse dëshiron t'i shesë palës blerëse 100 % të kuotave të veta me vlerë 1 000.000 lekë (njëmilionë lekë) .
- 1.4 Pala blerëse me blerjen nga pala shitëse bëhet zotërues i gjithësej 100 % të kapitalit themeltar në shoqërinë "SIGURIA PRESION" sh.p.k.
- 1.5 Për këtë shitje ka dhënë pëlqimin ortaku i vetëm me vendimin datë 13.02.2020.

### NENI 2

#### ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

- 2.1 Shitësi në marrëveshje me palën blerëse shet 100 %, të kuotave të veta, kundrejt çmimit 1 000 000 lekë (njëmilion)
- 2.2 Pala shitëse deklaron se do të kryhet me bankë. Mandati bankar do të jetë pjesë e kontratës dhe dokument i vetem, i cili provon likuidimin e cmimit.

### NENI 3

#### TRANSFERIMI KAPITALIT

- 3.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat që shiten, që pala shitëse zotëron, i kalon palës blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës.





3.2 Shitësi i dorëzon blerësit të gjitha dokumentat, deklaratat, ose çertifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në favor të blerësit dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4  
DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1 Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse për sa më poshtë vijon:
- 4.2 Pala shitëse është pronare e ligjshme e pjesëve që blihen nga blerësi, të cilat janë plotësisht të nënshkruara dhe të paguara plotësisht;
- 4.3 Shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha cdo detyrim të detyrueshme për t'u paguar;
- 4.4 Shitësi deklaron se do të paguajë cdo detyrim, për të cilat nuk ka dijeni, por që mund të ekzistojnë e të rëndojë mbi shoqërinë, para kësaj date të nënshkrimit të kontratës.
- 4.5 shitësi garanton dhe vërteton eshte me dokumentin e marrë, nga regjistri i barrëve siguroese se kuotat janë të lira nga cdo detyrim ndaj të tretëve. Ky dokument i bashkalidhet kontratës dhe është pjesë përbërëse e saj.

NENI 5  
DETYRIMET TATIMORE

- 5.1 Pala blerëse ble 100 % të kapitalit themeltar si më sipër me gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 6  
KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- 6.1 Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 6.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë, ose çdo marrëveshje tjetër, ose dokument të zbatuar midis palëve për zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 6.3 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.
- 6.4 Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njëres nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje ligjërish të vlefshme, që korrespondon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

NENI 7  
NJOFTIMET

- 7.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikime mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt nëse i dorëzohen në dorë, i dërgohen me postë të regjistruar ose me faks palës në adresën e paracaktuar nga palët.

NENI 8  
DISPOZITA E FUNDIT

- 8.1 Kontrata hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore e përbërë nga 2 fletë secila.
- 8.2 Kontrata u nënshkrua prej nesh palëve rregullisht sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

Viktor Kostandini

Jep pëlqimin bashkëshortja Shpresa Kostandini

Shpresa Kostandini

SH



BLERËSI

Ergest Mileti

ERGEST MILETI





# SHOQËRIA „SIGURIA PRESION” SH.P.K

## VENDIM

### I

## ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË

Sot në datën 13.02.2020 unë Viktor Kostandini, ortaku i vetëm i shoqërisë „SIGURIA PRESION” sh.p.k, e themeluar në dt. 07.08.2008, e regjistruar person juridik shqiptar, e pajisur me Nipt K82008005K me kapital themeltar 100.000,000 leke, në bazë të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe statutit të saj:

### VENDOSA:

1. Të shes 100 % të kuotave të kapitalit themeltar që zotëron në shoqëri blerësit z. Ergest Mileti, i datëlindjes 02.07.1990, i regjistruar me nr. personal J00702026K.
2. Me realizimin e transferimit të kuotave, z. Ergest Hoxha bëhet ortakë i vetëm shoqërisë së mësipërme dhe njëkohësisht zotërues me 100% të kuotave të saj.
3. Heq dora nga detyra e administratorit të shoqërisë
4. Administratorit i shoqëroisë do të jetë Z. Ergest Mileti i cili do ta ushtrojë këtë detyrë për një periudhë 5-vjeçare.
5. Pasqyrimin e këtij vendimi në aktet e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### ORTAKU I VETËM

VIKTOR KOSTANDINI



ERGEST MILETI



*Handwritten signature of Ergest Hoxha.*